



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2022:083216

Datë: 26.08.2024

Numri i dokumentit: 06084138

C.nr.1704/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditësve H . D . , J . S . , S . S.1., Sebahate Sadiku, Sadik Mjeku, të cilët i përfaqëson avokat Lumbardh Haxhaj nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Obiliqit, të cilën e përfaqëson avokati Blerim Cakolli nga Prishtina, me autorizim bartës nga avokati Nazim Mehmeti nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim i pagave mbi bazën e inflacionit, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik, në të cilën të pranishëm ishin përfaqësuesit e palëve, me datë 26.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve H . D . , J . S . , S . S.1., S . S. 2.dhe S . M.dhe DETYROHET e paditura Komuna e Obiliqit që paditësve H . D . , J . S . , S . S.1. dhe S.S. 2., në emër të kompensimit të pagave në bazë të përqindjes së inflacionit për periudhën 01.05.2019 – 21.11.2022 t’ia paguajë shumën prej 809.98 euro, për secilin paditës veç e veç, si dhe paditësit S . M.në emër të kompensimit të pagave në bazë të përqindjes së inflacionit për periudhën 01.05.2019 – 11.02.2022 t’ia paguajë shumën prej 370.46 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data 26.04.2022, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësve t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 737 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m i

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 26.04.2022, kanë paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Obiliqit, me objekt kontesti kompensim të pagave në bazë të inflacionit.

Paditësit, në padi, si dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, kanë deklaruar se të gjithë paditësit janë të punësuar në ShFMU/, Komuna e Obiliqit dhe paga bazë e tyre për periudhën e kërkesës, përkatësisht për 01.05.2019 – 21.11.2022 ka qenë 421 euro, përveç për paditësin S. M. , i cili ka dalë në pension me datë 11.02.2022, dhe për të kërkesa është për periudhën 01.05.2019 –

11.02.2022. Padiësit nuk janë paguar asnjëherë nga e paditura për kërkesën për kompensim në bazë të inflacionit. Kanë shtuar se sipas Entit të Statistikave shkalla e inflacionit ka qenë si në vijim për vitin 2019 – 2.7 %, për vitin 2020 – 0.2%, për vitin 2021 – 3.4%, dhe për vitin 2022 – 11.6 %. Kështu, në këtë seancë, e kanë rregulluar, përkatësisht ndryshuar padinë në aspektin objektiv, ashtu që kanë kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësve H . D . , J . S . , S.S.1 . , S.S.2 , S . M.dhe të detyrohet e paditura Komuna e Obiliqit që paditësve H . D . , J . S . , S . S.1., S.S.2 , në emër të kompensimit të pagave në bazë të përqindjes së inflacionit për periudhën 01.05.2019 – 21.11.2022 t'ia paguajë shumën prej 809.98 euro, për secilin padiës veç e veç, si dhe padiësit S . M. në emër të kompensimit të pagave në bazë të përqindjes së inflacionit për periudhën 01.05.2019 – 11.02.2022 t'ia paguajë shumën prej 370.46 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data 26.04.2022 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë prej 737 euro.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj, në përgjigje në padi dhe në seancë gjyqësore e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar, për arsye se e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive të datës 18.04.2017, në të cilën e bazojnë kërkesëpadinë padiësit, e rrjedhimisht kjo kontratë nuk mund të ketë implikime financiare për të paditurën, por vetëm për palët nënshkruese.

Sa i përket gjendjes faktike ka deklaruar se për ta nuk është kontestuese gjendja faktike, por vetëm baza ligjore. Po ashtu, sipas të paditurës, kërkesa e paditësve pas ndryshimit të sotëm nuk është e parashkuar.

Gjykata për ta vërtetuar sa më saktë dhe drejtë gjendjen faktike, administroi provat materiale si: Kontrata e punës e datës 01.09.2020, me numër protokollit 23 – IX/2020; Lista e pagave e muajit janar 2021; Kontrata e punës e datës 25.01.2016, me numër protokollit 21/2016; Lista e pagave e muajit janar 2021; Kontrata e punës e datës 25.01.2016, me numër protokollit 23/2016; Lista e pagave e muajit janar 2021; Kontrata e punës e datës 01.10.2020, me numër protokollit 02 - X/2020; Lista e pagave e muajit janar 2021; Kontrata e punës e datës 25.01.2016, me numër protokollit 16/2016; Lista e pagave e muajit janar 2021.

Pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, përkatësisht përfaqësuesve të tyre, gjykata erdhi në përfundim se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese gjendja faktike se të gjithë padiësit janë të punësuar në Sh.F.M.U./, Komuna e Obiliqit dhe paga bazë e tyre për periudhën e kërkesës, përkatësisht për 01.05.2019 – 21.11.2022 ka qenë 421 euro, përveç për padiësin S.M. , i cili ka dalë në pension me datë 11.02.2022, dhe për të kërkesa është për periudhën 01.05.2019 – 11.02.2022. Nuk ishte kontestues as fakti se padiësit nuk janë paguar asnjëherë nga e paditura për kërkesën për kompensim në bazë të inflacionit, dhe se sipas Entit të Statistikave shkalla e inflacionit ka qenë si në vijim: për vitin 2019 – 2.7 %, për vitin 2020 – 0.2%, për vitin 2021 – 3.4%, dhe për vitin 2022 -11.6 %.

Kjo gjendje faktike edhe pse jokontestuese, ishte në përputhje të plotë me provat e administruara më sipër.

Gjykata konstaton se në mes të palëve ndërgjyqëse kontestuese është vetëm baza ligjore lidhur me kërkesën e paditësve.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK) e miratuar dhe e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) me datën 18.04.2017, e cila ka qenë e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj, e deri me datë 21.01.2021, si dhe në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, e cila ka qenë në fuqi deri më 21.11.2022, në vazhdim KKAK-të.

Neni 2, paragrafi 1 i KKAK-ve përcakton se *“Dispozitat e Kontratës Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit para universitare (parashkollor, fillore, të mesme të ultë, të mesme të lartë, shkolla speciale dhe qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, [...]”*. Ndërsa, paragrafi 2 i të njëjtit nen përcakton se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat – DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in, etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.*

Po ashtu, me nenin 35, paragrafi 10 të KKAK-ve, parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*.

Zbatimi i dispozitave të lartcekura, në këtë rast, është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023, të datës 05.10.2023.

Duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, si dhe dispozitat ligjore të lartcekura gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim t’ia paguajë paditësve kompensimin e pagave për shkak të inflacionit. Kjo pasi që gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese që paditësit gjatë periudhës së kërkesës, periudhë kjo sa kanë qenë në fuqi të dy kontratat kolektive, nuk janë kompensuar sipas shkallës së përqindjes në bazë të inflacionit, ndërsa ky kompensim arrin lartësinë e aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e llogaritur pagën bazë të paditësve në shumë prej 421 euro, me shkallën e përqindjes sipas Entit të Statistikave të Kosovës, e që ishte si në vijim: për vitin 2019 – 2.7%, për vitin 2020 – 0.2%, për vitin 2021 – 3.4%; dhe për vitin 2022 -11.6 %.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës, gjykata vlerëson se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe si të tilla nuk paraqesin bazë për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve, për shkak se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditësve lidhur me kompensimin e pagës në bazë të inflacionit edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratave Kolektive të Arsimit, të vitit 2017 dhe 2021, pasi që në nenin 2 të Kontratave është përcaktuar se *“kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të”*.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësve në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së

shpenzimeve të procedurës gjykata u bazua në Rregulloren për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, dhe Udhëzimin Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore. Shuma prej 737 euro konsiston në shpërblimin për përpilimin e padisë në shumë prej 312 euro, shumën prej 405 për seancë gjyqësore dhe 20 euro për taksë gjyqësore.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

C.nr.1704/22, datë 26.08.2024

Gjyqtari,
Freskim Musliu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.